

# **VLERËSIMI I REZULTATEVE SHKENCORE DHE I SHKENCËTARËVE NË SHKENCAT E NATYRËS SIPAS TRENDEVE BASHKËKOHORE**

**Fetah Podvorica<sup>1</sup> Shemsedin Dreshaj<sup>2</sup> Ramë Vataj<sup>3</sup> Bajram Berisha<sup>4</sup>**

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë Republika e Kosovës

Email:

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë Republika e Kosovës

Email:

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë Republika e Kosovës

Email:

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë Republika e Kosovës

Email:

## **Përmbledhje**

Qëllimi primar i aktiviteteve shkencore është avancimi i dijes në një fushë të caktuar të hulumtimit. Ky përparim dëshmohet me anë të publikimeve origjinale shkencore siç janë artikujt në revistat shkencore, përmbledhjet e konferencave shkencore, monografitë shkencore si dhe përmes patentimeve. Vlerësimi i të arriturave dhe rezultateve shkencore si dhe vlerësimi i nivelit shkencor të shkencëtarëve ka qenë gjithmonë dhe vazhdon të ngelet një sfidë e veçantë për komunitetin shkencor si në Kosovë ashtu edhe në botë. Në faza të ndryshme të zhvillimit në të kaluarën, parametra të ndryshëm kanë vendosur për vlerësimin e cilësisë së rezultateve shkencore, respektivisht për nivelin e kontributit të rezultateve të caktuara shkencore në “shtimin” e dijes universale. Publikimi i „punimit origjinal shkencor“, ngelet produkti kryesor në bazë të së cilit vlerësohet cilësia e punës shkencore të individit ose grupit të caktuar shkencor, ndërkaq revista ku është botuar punimi, tregon për „nivelin“ shkencor të autorit dhe të institucionit. Zhvillimi i shpejtë i informatikës dhe internetit në këto deceniet e fundit ka mundësuar kategorizimin dhe sistematizimin e rezultateve shkencore, respektivisht akumulimin e shpejtë të dijes universale. Aktualisht, platforma të ndryshme elektronike të shkencës dhe inovacionit mundësojnë gjetjen e shpejtë dhe përpunimin e informatave të dëshiruara nga të gjitha fushat shkencore. Këto web-faqe shkencore ofrojnë të dhëna të rëndësishme edhe për sasinë dhe cilësinë e të arriturave shkencore të hulumtuesve të veçantë, të cilët kanë arritur që të publikojnë rezultatet e tyre në revista të indeksuara nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare shkencore. Parametrat kryesor në të cilët aktualisht bazohet vlerësimi i të

arriturave shkencore të hulumtueseve janë: numri i publikimeve, niveli i revistave shkencore (të indeksuara, me „impact factor“ etj.) në të cilat publikohen artikujt shkencor, numri i citimeve që e paraqet interesin që e ka zgjuar te komuniteti shkencor puna e autorit si dhe parametrat tjerë bashkëkohor si Indeksi i Hirshit („h-index“) etj.

The 1st International Conference on Research and Education – Challenges Toward the Future (ICRAE2013), 24-25 May 2013,  
University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Shkodra, Albania